VENDIM
Nr. 641, datë 19.9.2012

PËR MIRATIMIN NË PARIM, TË MARRËVESHJES NDRYSHUESE NË MARRËVESHJEN E HUAS, NDËRMJET SHQIPËRISË DHE BANKËS NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM (IBRD), PËR FINANCIMIN SHTESË TË PROJEKTIT "OFRIMI I SHËRBIMEVE SOCIALE"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 26 të ligjit nr. 9665, datë 18.12.2006 "Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huas në Republikën e Shqipërisë", dhe të neneve 5 e 7 të ligjit nr. 8371, datë 9.7.1998 "Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare", me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin në parim, të marrëveshjes ndryshuese në marrëveshjen e huas, ndërmjet Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD), për financimin shtesë të projektit "Ofrimi i shërbimeve sociale", sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha